

## **KODI I SJELLJES**

# **PËR MBROJTJEN E TË DREJTËS SË INDIVIDIT PËR PRIVATËSI NË TRAJTIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE (KODI I PRIVATËSISË)**

Telekom Albania



## TABELA E PËRMBAJTJES

- 1 QELLIMI
- 2 FUSHA E ZBATIMIT
- 3 TE DREJTAT E AKSESIT
- 4 PERSHKRIMI
  - 4.1 Natyra Ligjore e Kodit të Sjelljes – Lidhja e Kodit me Legjislacionin Kombëtar dhe European
  - 4.2 Transparenca e Mbrojtjes së të Dhënave
  - 4.3 E drejta e Subjektit për Informim dhe Akses
  - 4.4 Disponueshmëria e Informacionit
  - 4.5 Kërkesat e Lejueshme për Trajtimin e të Dhënave – Miratimi nga Subjekti i të Dhënave
  - 4.6 Përdorimi i të Dhënave Personale
    - 4.6.1 Përdorimi i të Dhënave Personale për Qëllime të Drejtëpërdrejta Marketingu
  - 4.7 Kategoritë e Veçanta të të Dhënave Personale
  - 4.8 Parimet Lidhur me Cilësinë e të Dhënave
  - 4.9 Arkivimi i të Dhënave
  - 4.10 Transmetimi i të Dhënave tek Palë të Treta
  - 4.11 Përgjegjësia
  - 4.12 Proçesimi të Dhënave nga Nën-Kontraktorët
  - 4.13 Specialistit Përgjegjës
  - 4.14 Kontrollat për nivelin e Mbrojtjes së të Dhënave
  - 4.15 Masat Teknike, Organizative dhe ato lidhur me Punonjësit
  - 4.16 Të Drejtat e Subjekteve të të Dhënave
  - 4.17 E Drejta për t'u Ankuar / E Drejta për të Fshirë të Dhënat
  - 4.18 E Drejta për Korrigjim
  - 4.19 E Drejta për Sqarime dhe Komente
  - 4.20 Ushtrimi i të Drejtave
  - 4.21 Përgjegjësia e Trajtimin të të Dhënave Personale
  - 4.22 Koordinimi nga Specialisti i Grupit
  - 4.23 Detyrat e Mbikqyrjes dhe Këshillimit
  - 4.24 Trajnimi dhe Angazhimi i Punonjësve
  - 4.25 Bashkëpunimi me Autoritetet Mbikqyrëse
- 4.26 PERKUFIZIME

## 1 QELLIMI

Qëllimi i këtij Kodi është të sigurojë një nivel uniform të lartë të mbrojtjes të të dhënave lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve, brenda kompanive të Grupit OTE përmes zbatimit rigoroz të legjislacionit European lidhur me mbrojtjen e të dhënave dhe konfidencialitetit të komunikimit.

## 2 FUSHA E ZBATIMIT

Politika e Grupit zbatohet për të gjithë punonjësit e kompanive të Grupit OTE, pavarësisht nëse janë anëtarë të Bordit Drejtues, staf drejtues, ekzekutivë të lartë, apo punonjës.

## 3 TE DREJTAT E AKSESIT

Aksesi në këtë dokument u lejohe të gjithë punonjësve të OTE-së dhe kompanive të Grupit OTE.

## 4 PERSHKRIMI

### 4.1 Natyra Ligjore e Kodit të Sjelljes – Lidhja e Kodit me Legjislacionin Kombëtar dhe European

1. Ky Kod Sjellje vendos direktiva të përgjithshme lidhur me trajtimin e të dhënave personale brenda Grupit OTE, është i detyrueshëm për të gjitha kompanitë e Grupit OTE dhe hyn në fuqi menjëherë pas publikimit nga stafi manaxherial përkatës i kompanive të Grupit OTE në faqen zyrtare të kompanisë.
2. Ky Kod zbatohet në ndërthurje me legjislacionin kombëtar dhe European në fuqi lidhur me mbledhjen, trajtimin dhe përdorimin e të dhënave personale të të gjithë subjekteve, veçanërisht lidhur me të dhënat personale të klientëve dhe punonjësve të të gjitha kompanive të Grupit, si dhe – për të gjithë listën e grupit- kompanitë – aksionerët.
3. Kompanitë e Grupit do të trajtojnë të dhënat personale dhe t'i transmetojnë ato tek Autoritetet Publike, nëse u kërkohet, në përputhje me legjilacionin në fuqi në atë vend, i cili rregullon veprimtarinë e secilës kompani të Grupit.

### 4.2 Transparenca e Mbrojtjes së të Dhënave

Personat, të cilëve u referohen të dhënat personale ("subjekte të të dhënave" në kuptim të nenit 28 këtu), do të kenë akses në të gjithë informacionin lidhur me trajtimin e të dhënave personale përmes metodave të duhura të informimit, veçanërisht përmes publikimit të Kodit të Sjelljes në faqen zyrtare të internetit të kompanisë.

### 4.3 E drejta e Subjektit për Informim dhe Akses

1. Subjektet e të Dhënave kanë të drejtën të informohen nëse të dhënat e tyre personale janë trajtuar apo po trajtohen.
2. Subjekti i të Dhënave duhet të informohet në mënyrën e duhur dhe qartë për të dhënat e mëposhtme:
  - a. Identitetin e kontrolluesit/ve të të dhënave si dhe detajet e kontaktimit me ta.
  - b. Të dhënat personale lidhur me subjektin, si dhe origjinën e tyre.
  - c. Qëllimi i menduar dhe synimi i mbledhjes, procesimit dhe/ose përdorimit të të dhënave personale. Ky informacion duhet të përfshijë se cilat të dhëna po regjistrohen dhe/ose procesohen/përdoren, pse dhe për çfarë qëllimi dhe për sa kohë.
  - d. Mënyra e procesimit dhe në rastin e transmetimit tek palë të treta, marrësin dhe qëllimin e transmetimit të të dhënave.
3. Informacioni përkatës duhet të jetë në dispozicion të aplikuesit në një formë të kuptueshme dhe brenda një kohe të arsyeshme. Në përgjithësi, informacioni duhet dhënë me shkrim.
4. Subjektet e të dhënave kanë të drejtën të kërkojnë dhe të marrin nga Kontrolluesi, informacion lidhur me trajtimin e të dhënave të tyre personale, dhe Kontrolluesi është i detyruar t'u përgjigjet me shkrim, në një formë të kuptueshme dhe pa vonesa të qëllimshme, brenda një kohe të arsyeshme ose në periudhën përfundimtare të caktuar nga legjislacioni kombëtar.

5. Kompania, atëherë kur e lejon legjislacioni në vend, mund të vendosë një tarifë për informacionin e dhënë.

#### 4.4 Disponueshmëria e Informacionit

Informacioni duhet të jetë i disponueshëm për subjektet e të dhënave, atëherë kur të dhënat mblidhen për herë të parë dhe sa herë që të kërkohet në vijim.

#### 4.5 Kërkesat e Lejueshme për Trajtimin e të Dhënave – Miratimi nga Subjekti i të Dhënave

1. Trajtimi i të dhënave personale lejohet vetëm në rastin kur subjekti jep miratimin e vet. Miratimi nga subjektet e të dhënave duhet të përmbajë veçoritë e mëposhtme:

a. Miratimi nga subjektet e të dhënave do të merret, në rastin më të vonë, kur të fillojë mbledhja, procesimi ose përdorimi i të dhënave.

b. Miratimi duhet të jepet në mënyrë të qartë dhe vullnetarisht, dhe në një formë në përshtatje me rrethanat.

c. Miratimi duhet të jepet mbi një bazë të informuar lidhur me qëllimin e trajtimit, marrësin ose listën e marrësve, si dhe identitetin e Kontrollorit ose proçeduesit të të dhënave.

2. Miratimi i dhënë nga subjektet mund të tërhiqet në çdo kohë dhe pa asnjë efekt prapaveprues.

3. Trajtimi i të dhënave pa marrë më parë miratimin e subjektit lejohet në rastin kur ky trajtim është i nevojshëm për përmbushjen e një kontrate, ku bëjnë pjesë të dhënat e subjektit ose kur është e lejuar nga legjislacioni kombëtar apo European.

#### 4.6 Përdorimi i të Dhënave Personale

Të Dhënat Personale nuk duhet të përdoren për qëllime të tjera, përveç qëllimeve fillestare për të cilat janë mbledhur këto të dhëna.

##### 4.6.1 Përdorimi i të Dhënave Personale për Qëllime të Drejtëpërdrejta Marketingu

1. Të Dhënat Personale do të përdoren për qëllime të drejtëpërdrejta marketingu në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe European.

2. Subjektet e të Dhënave gëzojnë të drejtën të ngrejë një ankesë ndaj kompanisë, e cila trajton të dhënat e tyre personale për qëllime të drejtëpërdrejta marketingu.

3. Kompanitë e Grupit OTE janë të detyruara – me marrjen e kërkesës nga subjekti – të informojnë subjektet për të drejtën e larpërmedur, si dhe për mënyrën dhe proçesin e zbatimit të kësaj të drejte.

#### 4.7 Kategoritë e Veçanta të të Dhënave Personale

Ndalohet mbledhja dhe trajtimi i të Dhënave Personale të kategorive të veçanta, me përjashtim të rastit kur subjekti në mënyrë të qartë ka dhënë miratimin e vet ose kur trajtimi i të dhënave lehojet nga legjislacioni i zbatueshëm kombëtar ose European. Trajtimi i të dhënave lejohet edhe në rastin kur është e nevojshme për të proçeduar të dhënat në përmbushje të të drejtave dhe detyrimeve të kompanisë përgjegjëse, në fushën e ligjit të punës, me kusht që ky veprim të jetë i lejueshëm si rrjedhojë dhe bazuar në ligjin e zbatueshëm në atë vend.

## 4.8 Parimet Lidhur me Cilësinë e të Dhënave

1. Të gjitha kompanitë duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që të dhënat personale janë në çdo kohë të sakta, dhe kur lind nevoja, të rifreskohen (cilësia e të dhënave).
2. Kompanitë e Grupit duhet të marrin gjithashtu të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që të dhënat e pasakta ose të mangëta të fshihen ose korrigjohen.
3. Të Dhënat Personale duhet të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe jo të tepruara lidhur me qëllimet për të cilat janë përdorur. Të dhënat do të mbledhen vetëm për qëllime specifike, të përcaktuara dhe të ligjshme, bazuar në një kërkesë përkatëse dhe duhet të procesohen vetëm në përputhje me këto qëllime (shmangie e të dhënave).
4. Të Dhënat Personale duhen mbajtur në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimin e mbledhjes së tyre ose për procesimin e mëtejshëm të tyre. Pas kësaj periudhe, kompanitë do të shkatërrojnë ose fshijnë veçoritë identifikuese të subjekteve të të dhënave (anonimizimi). Anonimizimi do të kryhet në mënyrë të tillë që të mos lejojë zbulimin e identiteteve të subjekteve të të dhënave, ose që mund të zbulohen vetëm përmes shumë përpjekjesh të stërmundimshme.

## 4.9 Arkivimi i të Dhënave

Parimet e procesimit me të dhënat, në mënyrë të veçantë parimet e ekonomisë të të dhënave dhe shmangia e të dhënave, do të merren parasysh gjatë zhvillimit të arkivës të të dhënave. Për zhvillimin e një arkivi personal të dhënash do të zbatohet ligji kombëtar në fuqi.

## 4.10 Transmetimi i të Dhënave tek Palë të Treta

Ndalohet transmetimi i të dhënave tek Palë të Treta, me përjashtim të rastit kur subjekti në mënyrë të qartë ka dhënë miratimin e vet ose në rast se transmetimi i të dhënave është i nevojshëm për të përmbushur kërkesat kontraktuale kundrejt të dhënave të subjektit, ose në të gjitha rastet kur legjislacioni kombëtar në fuqi e lejon transmetimin e të dhënave ndaj palëve të treta.

## 4.11 Përgjegjësia

Gjatë transmetimit të të dhënave drejt një pale te tretë, që nuk është ent/institucion publik, kompania që ka mbledhur në fillim të dhënat, duhet të bashkëpunojë me palën e tretë në mënyrë që të sigurohet se të dhënat personale po trajtohen në mënyrë të ligjshme. Kontrolluesi, në mënyrë treguese dhe të qartë do të sigurojë që ai bashkë me marrësin e të dhënave do të diskutojnë dhe miratojnë masat e duhura për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave. Në ato vende ku marrëveshjet me entet mbyllen pa nivelet e duhura te mbrojtjes, duhen siguruar garanci të mjaftueshme në lidhje me mbrojtjen e së drejtës së privatësisë së individit dhe të drejtës së ushtrimit të të drejtave në lidhje me këtë, pa paragjykuar lejen e dhënë më parë nga autoritetet kompetente, nesë kërkohet nga legjislacioni përkatës vendas.

## 4.12 Proçesimi të Dhënave nga Nën-Kontraktorët

1. Në rastin kur kompania angazhon shërbimet e një nën-kontraktori, atëherë, kontrata e shkruar përkatëse do t'i referohet detyrimeve të nënkontraktorit si palës së angazhuar për procesimin e të dhënave. Këto dispozita do të vendosin udhëzimet e kompanisë (pala që kontrollon të dhënat) lidhur me llojin dhe mënyrën e procesimit me të dhënat personale, qëllimin e procesimit të këtyre të dhënave si dhe masat organizative dhe teknike që kërkohen për mbrojtjen e të dhënave.

2. Nënkontraktori nuk do të përdorë të dhënat personale që i janë dhënë (zbuluar) atij, si pasojë e marrëdhënies kontraktuale me kompaninë përkatëse, pa marrë më parë miratimin me shkrim të saj.

3. Në përzgjedhjen e një nënkontraktori do të merren në konsideratë kriteret e sigurisë të të dhënave personale dhe trajtimi i ligjor i tyre.

#### 4.13 Specialisti Përgjegjës

1. Secila e kompani e Grupit OTE do të caktojë një specialist përgjegjës që të sigurojë se departamentet e ndryshme janë informuar siç duhet për legjislacionin e zbatueshëm, si dhe proceset e brendshme të Grupit dhe politikën për mbrojtjen e të dhënave.

2. Specialisti duhet të jetë i përfshirë në projektimin e produkteve dhe shërbimeve të reja që në fazat e para në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen e të dhënave personale.

3. OTE do të caktojë një Specialist, përgjegjës për të gjithë grupin, për mbrojtjen e të dhënave personale, i cili raporton drejtëpërdrejtë tek Bordi Drejtues i OTE-së dhe koordinon strategjinë e kompanisë lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin e komunikimeve.

4. Secila kompani do të bashkëpunojë me Specialistin e Grupit OTE në mënyrë që të vendosë një nivel të lartë dhe uniform të mbrojtjes së të dhënave brenda kompanive të Grupit OTE.

#### 4.14 Kontrollat për nivelin e Mbrojtjes së të Dhënave

Kontrolle të brendshme lidhur me proceset e trajtimit të të dhënave, si dhe lidhur me proceset e heqjes dorë nga e drejta e privatësisë, duhet të kryhen rregullisht për të rishikuar efektshmërinë e masave që janë implementuar. Këto audite/kontrolle duhet të kryhen nga Specialisti i çdo kompanie përkatëse, përgjegjës për mbrojtjen e privatësisë të të dhënave personale, ose nga sektorët e tjerë të autorizuar për të kryer kontrolle/audite të brendshme.

#### 4.15 Masat Teknike, Organizative dhe ato lidhur me Punonjësit

1. Punonjësit e Kompanive, kur fillojnë punë në kompani dhe çdo vit, do të nënshkruajnë dispozita të caktuara konfidencialiteti, si dhe dispozita zbatimi lidhur me proceset e brendshme të implementuara në kompani për mbrojtjen e të dhënave personale të klientëve, punonjësve dhe, për të gjitha kompanitë e ndërthurura, aksionerët etj.

2. Proceset e brendshme të secilës kompani duhet të përfshijnë masat e duhura organizative dhe teknike, në mënyrë që të sigurojë procesimin ligjor të të dhënave personale. Këto procese duhet të paktën të garantojnë si mëposhtë:

a. Ndalimin e personave të paautorizuar në marrjen e aksesit në sistemin e procesimit të të dhënave ku procesohen ose përdoren të dhënat personale (kontroll aksesi fizik)

b. Mos përdorimin e sistemeve të procesimit të të dhënave nga persona të paautorizuar (kontrolli për mohim-përdorimi)

c. Të sigurohen që personat e autorizuar për të përdorur sistemin e procesimit të të dhënave do të kenë akses ekskluzivisht dhe vetëm në ato të dhëna për të cilat kanë marrë autorizim aksesi, dhe që të dhënat personale, gjatë procesit ose përdorimit ose regjistrimit, nuk do të mund të lexohen, kopjohen, ndryshohen ose të fshihen nga persona të paautorizuar (kontroll i aksesit tek të dhënat)

d. Të sigurohen se gjatë rrjedhës së transmetimit elektronik ose gjatë transportimit apo regjistrimit tek mbartësi i të dhënave, të dhënat personale nuk do të mund të lexohen, kopjohen, ndryshohen ose të fshihen nga persona të paautorizuar, dhe se do të jetë e mundur të ekzaminohet dhe të vendoset se ku do të transmetohen të dhënat personale nga paisja e transmetimit të të dhënave (kontrolli i transmetimit të të dhënave)

e. Të sigurohen se do të jetë e mundur, në retrospektivë, të ekzaminohet dhe të vendoset nëse të dhënat personale janë futur në sistemet e procesimit të të dhënave personale, nëse janë modifikuar dhe/ose hequr, dhe nga kush janë kryer këto veprime (kontrolli i hyrjes së të dhënave)

f. Të sigurohen se të dhënat personale të cilat janë proçeduar nga nënkontraktorët, mund të proçesohen vetëm në përputhje me udhëzimet e dhëna nga pala urdhëruese (kontrolli i nënkontraktorit)

g. Të sigurohen se të dhënat personale janë të mbrojtura ndaj shkatërrimit aksidental dhe/ose humbjes (kontrolli i disponueshmërisë)

#### 4.16 Të Drejtat e Subjekteve të të Dhënave

Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtën të kontaktojë kompaninë përgjegjëse dhe të pyesë lidhur me Kodin aktual të Sjelljes dhe të drejtat e tij/saj përmendur në pikën 4.3, 4.17 dhe 4.18 këtu.

#### 4.17 E Drejta për t'u Ankuar / E Drejta për të Fshirë të Dhënat.

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtën të ngrejë një ankesë pranë kompanisë përgjegjëse për përdorimin e të dhënave personale të tij/saj.
2. Të gjitha ankesat do të drejtohen tek Specialisti përkatës për mbrojtjen e privatësisë të të dhënave personale ose tek personi përkatës i autorizuar dhe do të përfshijnë një kërkesë për një veprim të caktuar si korrigjim, mospërdorim të përkohshëm, bllokim, mos transmetim, fshirje
3. E drejta për tu ankuar aplikohet edhe nëse subjekti i të dhënave ka dhënë në një rast të mëparshëm miratimin për përdorimin e të dhënave të veta personale
4. Të gjitha kërkesat e drejta për fshirjen e të dhënave do të plotësohen menjëherë. Këto kërkesa janë të drejta veçanërisht kur ka përfunduar afati i bazës ligjore për përdorimin e tyre. Për këtë arsye do të zbatohen periudha ruajtje/mbajtje të parashikuara me ligj.

#### 4.18 E Drejta për Korrigjim

Subjekti i të dhënave do të mund të kërkojë në çdo kohë korrigjimin e të dhënave personale, për sa kohë këto të dhëna janë të mangëta ose të pasakta.

#### 4.19 E Drejta për Sqarime dhe Komente

1. Nëse një subjekt i të dhënave pretendon se të drejtat e tij/saj janë shkelur në formën e procesimit të paligjshëm të të dhënave, në mënyrë të veçantë nëse ka patur shkelje të këtij Kodi Sjellje, kompanitë përgjegjëse do të sqarojnë faktet pa asnjë vonesë të paarsyeshme dhe brenda afatit kohor të parashikuar nga ligji në fuqi. Në këtë rast ata do të bashkëpunojnë dhe ti sigurojnë njëri-tjetrit të gjithë informacionin e nevojshëm për të ngritur faktet e çdo rasti.
2. Departamenti përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave dhe më i afërt më çështjet në fjalë brenda kompanisë, duhet të koordinojë të gjithë korrespondencën përkatëse me subjektin e të dhënave.



## 4.20 Ushtrimi i të Drejtave

Ushtrimi i këtyre të drejtave nga subjektet e të dhënave nuk do të lejojë krijimin e situatave të paforshme për ta.

## 4.21 Përgjegjësia e Trajtimin të të Dhënave Personale

1. Kompanitë do të garantojnë përputhjen e tyre me legjislacionin përkatës lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe heqjen dorë nga privatësia si dhe dispozitat e Kodit të Sjelljes

2. Specialisti përgjegjës për mbrojtjen e privatësisë së të dhënave personale në kompaninë përkatëse, do të informohet menjëherë për çdo rast shkeljeje (përfshi këtu edhe dyshimin për shkelje) të dispozitave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të këtij Kodi Sjelljeje. Në rast se ka ndonjë incident që ka lidhje me më shumë se një kompani, atëherë do të njoftohet menjëherë edhe specialisti përkatës i mbrojtjes së privatësisë së të dhënave personale që është përgjegjës për të gjithë Grupin.

3. Specialisti i kompanisë, përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale, duhet të informohet për çdo ndryshim në legjislacion lidhur mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Specialistit e secilës kompani të Grupit OTE duhet të koordinojnë aktivitetin e tyre brenda kuadrit të politikës së Grupit për Mbrojtjen e të Dhënave dhe të Heqjes Dorë nga Privatësia.

## 4.22 Koordinimi nga Specialisti i Grupit

1. Specialisti i Grupit, përgjegjës për mbrojtjen e privatësisë për të dhënat personale, në rastin e incidenteve të shkeljes së përgjithshme të dispozitave lidhur me mbrojtjen e të dhënave që rrezikojnë qëllimin e këtij Kodi Sjelljeje, do të koordinojnë aktivitetin e Specialistëve të secilës kompani.

2. Detyra e Specialistit të Grupit, përgjegjës për mbrojtjen e privatësisë për të dhënat personale, është të zhvillojë politikën e Grupit lidhur me mbrojtjen e të dhënave. Në përmbushje të këtij qëllimi duhet të bashkëpunojnë të gjithë Specialistët përkatës.

## 4.23 Detyrat e Mbikqyrjes dhe Këshillimit

1. Specialistët e kompanive do të jenë përgjegjës për monitorimin e përputhjes dhe pajtimit me rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave dhe me këtë Kod Sjelljeje.

2. Specialistët përkatës do të ekzaminojnë në vend të gjitha teknikat e procesimit që përfshijnë përdorimin e të dhënave personale.

## 4.24 Trajnimi dhe Angazhimi i Punonjësve

Kompanitë e Grupit kujdesen për trajnimin e punonjësve lidhur me trajtimin e ligjshëm të të dhënave personale si dhe për zbatimin e këtij Kodi Sjelljeje.

## 4.25 Bashkëpunimi me Autoritetet Mbikqyrëse

Kompanitë e Grupit OTE do të bien dakort për t'u përgjigjur kërkesave dhe të pajtohen me rekomandimet e autoriteteve mbikqyrëse, të cilat janë autorizuar për mbikqyrjen e zbatimit të legjislacionit përkatës lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe Heqjen Dorë nga e drejta për Privatësi.

## 4.26 Përkufizime

Grupi **OTE: O.T.E S.A** si dhe të gjitha kompanitë në të cilat OTE SA ka, drejtpërdrejtë ose jo, më shumë se 50 % të aksioneve, ose të cilat i kontrollojnë.

Kompania përgjegjëse ose përkatëse: Kompania, që është pjesë e Grupit OTE dhe përcakton qëllimet dhe mënyrat e procesimit të të dhënave të klientëve, punonjësve ose aksionerëve.

Subjekti i të Dhënave: Çdo person fizik apo juridik të cilit i referohen të dhënat dhe identiteti i të cilit njihet ose mund të zbulohet nga kompania përkatëse me të cilën ai është lidhur si klient, punonjës apo aksioner.

Të Dhënat personale: Çdo informacion lidhur me subjektin e të dhënave. Informacioni statistik që nuk e identifikon subjektin, nuk konsiderohet e dhënë personale.

Kategori të Veçanta të Dhënash: Nënkupton të dhëna që tregojnë origjinë raciale apo etnike, opinione politike, besime fetare ose filozofike, anëtarësinë në unione-tregtare apo shëndetsore ose akuza apo dënime për jetë kriminale seksuale, si dhe anëtarësim në shoqëritë që veprojnë në fushat e mësipërme.

Trajtimi i të dhënave personale: Nënkupton çdo veprim ose rend veprimesh që kryhet mbi të dhënat personale siç është mbledhja, regjistrimi, organizimi, arkivimi, përshtatja, kthimi, konsultimi, përdorimi, zbulimi përmes transmetimit, përhapja ose mundësimi tek të tjerët, radhitja apo kombinimi, bllokimi, fshirja apo shkatërrimi i tyre.

Miratimi: Nënkupton çdo tregim të qartë dhe specifik të vullnetit që është dhënë lirisht, prej ku subjekti i të dhënave shprehimisht dhe plotësisht i vetëdijshëm shpreh informimin dhe miratimin e vet ndaj procesimit të të dhënave të tij/saj personale. Ky informacion do të përfshijë të paktën informacion për sa i përket qëllimit të procesimit, marrësit ose kategoritë e marrësve të të dhënave personale si dhe emrin, emrin tregtar dhe adresën e Kontrolluesit dhe të përfaqësuesve të tij/saj, nëse ka të tillë. Ky miratim mund të tërhiqet në çdo kohë dhe pa pasoja prapavepruese.

Marrësit e të dhënave: Nënkupton çdo person fizik apo ent juridik, autoritet publik, agjenci ose ndonjë entitet tjetër ndaj të cilit zbulohen të dhënat, qofshin palë të treta ose jo.

Palë e tretë: Çdo person fizik apo ent juridik, autoritet publik, agjenci ose ndonjë entitet tjetër përveç subjektit të të dhënave, kontrolluesit, dhe personave të autorizuar për procesimin e të dhënave, me kusht që ata të veprojnë nën mbikqyrjen e drejtëpërdrejtë ose në emër të Kontrolluesit.

Kontrolluesi: Nënkupton çdo person që cakton qëllimin dhe mënyrat për procesimin e të dhënave personale, si p.sh çdo person fizik apo ent juridik, autoritet publik, agjenci ose ndonjë organizatë tjetër. Në ato vende ku qëllimet dhe mënyrat për procesimin e të dhënave caktohen nga ligjet kombëtare ose rregulloret e Komunitetit, atëherë edhe Kontrollori apo kriteret specifike për emërimin e tij/saj do të caktohen nga ligji i Komunitetit ose ai kombëtar.

Proçeduesi: Nënkupton çdo person që ka në zotërim të dhëna personale në emër të Kontrolluesit si p.sh çdo person fizik apo ent juridik, autoritet publik, agjenci ose ndonjë organizatë tjetër.

Arkiva/dosja e të Dhënave Personale: Nënkupton çdo bazë të organizuar të dhënash personale, dhe për të patur akses në to duhen marrë parasysh kriteret specifike.